



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Procesverbal nga konsultimi publik për Planin për Riintegrim të Qendrushëm

Me datën 22 Korrik, është mbajtur konsultimi publik për Planin për Riintegrim të Qëndrueshëm.

Njoftimi për mbajtjen e takimit publik është publikuar me 14.07.2026 në uebfaqe të komunës në vegzën:

https://ferizaj.rks-gov.net/ep-content/uploads/2026/07/Njoftim-per-konsultim-publik_plani-lokal-per-riintegrim.pdf

Në këtë konsultim publik ka marrë pjesë Besa Çarkagjiu-Bibaj, Vjosa Shabani, Misin Osmani, si dhe Shyhrete Topalli-Rexhepi.

Me datën 22 korrik duke filluar nga ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës, është mbajtur konsultimi publik për Planin për Riintegrim të Qendrushëm.

Në këtë takim publik kanë marrë pjesë 12 total prej tyre 8 femra dhe 4 meshkuj.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Sipas antarës së grupit punues Besa Çarkagjiu-Bibaj, ky plan synon zbatimin e koordinuar të politikave të riintegritimit dhe integritimit në nivel lokal, duke u fokusuar në riintegrimin e qëndrueshëm socio-ekonomik të personave të riatdhesuar dhe krijimin e një sistemi efektiv të shërbimeve që u përgjigjet nevojave të tyre.

Dokumenti përmban objektiva të qarta, aktivitete konkrete, masa zbatuese, institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse, afatet kohore, kostot e përafërta financiare, indikatorët e matjes së rezultateve dhe mekanizmat e verifikimit të zbatimit.

Plani është hartuar në përputhje me Planin e Veprimit në nivel qendror dhe në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Punëve të Brendshme, përkatësisht Departamentin përgjegjës për Riintegrim dhe Integritimin e të Huajve, duke reflektuar njëkohësisht nevojat specifike të personave të riatdhesuar në Komunën e Ferizajt.

Përmes këtij plani, Komuna e Ferizajt synon të sigurojë një qasje gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar, si dhe për integritimin e të huajve, duke kontribuar në përmirësimin e mirëqenies së tyre dhe fuqizimin e përfshirjes sociale në komunitet.

Qytetarët mund t'i dërgojnë propozimet e tyre në adresat elektronike:

- info.ferizaj@rks-gov.net
- xhevahire.dervishi@rks-gov.net
- Shyhrete.topalli@rks-gov.net



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT

KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA

MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002

E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Komuna e Ferizajt u bën thirrje qytetarëve që të marrin pjesë aktive në këtë proces, me qëllim që rregullorja e re të reflektojë sa më mirë nevojat dhe interesat e komunitetit.

Pyetje gjatë konsultimit nuk ka pasur, ndërsa konsultimi publik u mbyll në orën 10:50.

Procesmbajtëse

Shyhrete Topalli-Rexhepi